



**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA**  
**SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA**



Agj.nr. 136/12  
20.02.2012  
Prishtinë

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 18 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 20.02.2012 miratoi këtë

**QËNDRIM PARIMOR**

1. Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, që ka të bëjë me kthimin e punëtorit në vendin e punës, nuk paraqet titull përmbarues për gjykatën.
2. Për të vendosur lidhur me kërkesën për adoptimin, kompetente është Gjykata Komunale në procedurën jokontestimore.

**A r s y e t i m**

I. Ligji mbi Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës ka parashikuar dispozita të veçanta për zbatimin e vendimeve të Këshillit. Nëse me vendimin e Këshillit të lartpërmendur është gjykuar plotësisht në mënyrë të qartë kërkesa në të holla, duke i plotësuar kështu të gjitha kërkesat për përshtatshmërinë e vendimeve përmbaruese, në bazë të nenit 24 par. 1

përmbarues.

Vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, që kanë të bëjnë me kthimin e punëtorit në marrëdhënie pune, nuk paraqet titull përmbarues, pasi që ky nuk ka të bëjë me kërkesë në të holla.

II. Edhe pse Ligji mbi Familjen i Kosovës ka mandatar vetëm gjykatën që të vendosë për kërkesat lidhur me adoptimin, nuk ka përcaktuar qartë se cila është ajo gjykatë (cili nivel gjyqësor). Gjykata komunale është me kompetencë lëndore për të gjykuar në procedurë jokontestimore lidhur me këtë çështje, pasi që për adoptimin duhet të vendoset sipas rregullave të procedurës jokontestimore, siç është rasti edhe me kompetencat e tjera të natyrës së ngjashme, siç janë: privimi nga e drejta prindërore, kthimi i së drejtës prindërore, privimi nga aftësia për të vepruar, kthimi i aftësisë për të vepruar etj.

Kryetari i Gjykatës,

Dr.sc. Fejzullah Hasani

